

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

KiDo SH.P.K.

Neni 1 Emërtimi

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “KiDo” shpk.

Neni 2 Objekti i Aktivitetit

Shoqërisë ka për objekt: Shit-blerjen me pakicë dhe import eksportet të artikujve të ndryshëm për fëmijë dhe shit-blerjet me pakicë dhe import eksportet të pajisjeve të ndryshme për fëmijë, mobilie, aksesore të tyre, mjete kancelarike etj.

Neni 3 Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet për një periudhë kohe të papërcaktuar, duke nisur nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar.

Neni 4 Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr.Themistokli Germenji, pallati 11, kati 4, apartamenti 14, Tiranë, Shqipëri.

Neni 5 Kapitali i Shoqërisë

(1) Kapitali themeltar i Shoqërisë është i barabartë me 2,000,000 Lekë, dhe ndahet në (4) kuota, të zotëruara nga ortakët si vijon:

- Ortaku zj. Jonida Prifti, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerën 500,000 Lekë, përbërë nga kontribute në para, që përfaqëson 25% të kapitalit;
- Ortaku z.Fatjon Alldervishi, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerën 500,000 Lekë, përbërë nga kontribute në para, që përfaqëson 25% të kapitalit;

- Ortaku z.Marsel Cino, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerën 500,000 Lekë, përbërë nga kontribute në para, që përfaqëson 25% të kapitalit;
 - Ortaku zj.Suela Aldervishi, zotëron 1 (një) kuotë, në vlerën 500,000 Lekë, përbërë nga kontribute në para, që përfaqëson 25% të kapitalit.
- (2) Përgjegjësia e Ortakëve për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6 Administrimi

Shoqëria administrohet nga Administratorët e emëruar nga Asambleja e Ortakëve. Administratorët e shoqërisë janë **z. Marsel Cino**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë në datën 16.08.1971, me karte identiteti nr. 036799799 dhe **zj. Suela Aldervishi** shtetase shqiptare, lindur në Tiranë në datën 08.02.1979 me kartë identiteti nr.037148872. Administratorët emërohen për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me të drejtë ripërtëritje dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve. Secili administrator ka kompetencë të pakufizuar për të përfaqësuar i vetëm Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta, përfshirë çdo autoritet publik dhe gjyqësor.

Neni 7 Viti financiar


Vitet financiare janë të përcaktuara si vitet kalendarike.

Neni 8 Prishja e shoqërisë


Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë, në çdo moment dhe për çdo arsye, emërimi i likuidatorit do të miratohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

THEMELUESIT

[26.04.2022]


[emër/mbiemër]


[emër/mbiemër]


[emër/mbiemër]


[emër/mbiemër]



